

STATUTI

I

SHOQËRIË TREGTARE ME PËRQJEGJËSI TË KUFIZUAR "DronesVision Albania," SHPK

KREU I

Pjesa e përgjithshme

Ky statut i hartuar sot me datë 03.09.2025, akti i themelimit dhe ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", rregullojnë marrëdhëniet midis ortakëve të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "DronesVision Albania" SHPK.

KREU II

Emri, Forma, Zyra Qendrore, Objekti i Veprimtarisë, Kohëzgjatja, Degtë dhe Zyrat e Përfaqësimit, Përgjegjësia e Ortakëve

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin "DronesVision Albania". Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare "DronesVision Albania", ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "DronesVision Albania" SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën rruga "Koli Bano", Pall. nr. 21, kati 1-rë, Tiranë, Shqipëri.
3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria do të ushtrrojë aktivitetin e saj në fushën e:

- Montim, instalim prodhim, mirëmbajtje, eksport-import të dronëve, pajisje të levizshme pa pilot, ushtarake dhe civile, si dhe të pajisjeve të tjera teknologjike në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe survejimit.
- Projektim, zhvillim dhe inovacion teknologjik në fushën e dronëve, pajisje të levizshme pa pilot, elektronikës, sistemeve të automatizuara dhe inteligjencës artificiale (IA).
- Trajnim dhe certifikim profesional për përdorimin, mirëmbajtjen dhe pilotimin e dronëve dhe sistemeve të ngjashme.

- Shërbime inxhinierike, software dhe IT, përfshirë zhvillimin e aplikacioneve të kontrollit të dronëve, pajisje të levizshme pa pilot, sistemeve të mbikëqyrjes dhe platformave digitale.
 - Shërbime këshillimore dhe konsulence në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe teknologjisë ajrore.
 - Qendër kërkimi dhe zhvillimi (R&D) për teknologji të reja në industrinë e mbrojtjes dhe të sigurisë.
 - Prodhim dhe integrim të pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë për dronë, pajisje të levizshme pa pilot, dhe sisteme të lidhura.
 - Aktivitete partneritëti dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, përfshirë transferimin e teknologjisë dhe prodhimit lokal.
 - Shitje dhe blerje me shumicë e pakicë të dronëve, pajisjeve teknologjike dhe produkteve të lidhura, në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar.
 - Projektimi, prodhimi, riparimi, asgjësimi dhe tregtimi brenda dhe jashtë vendit të të gjitha llojeve të armëve ose pjesëve të armëve, përfshirë dhe armët ushtarake, municioneve, teknologjitë dhe pajisjet ushtarake, uniformat, mjete, pajisjet dhe sistemet e armatimit e komunikimit, si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtari.
- Shoqëria mund të bashkëpunojë me shqetësi të tjera, vendase apo të huaja, publike apo private, për përmirësimin e objektivit të aktivitetit të saj.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrtojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyra e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "DronesVision Albania" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakut/et nuk përgjigjet/n për detyrimet e shoqërisë "DronesVision Albania" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributëve të nënshkruara prej tyre.

KREU III

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat, Zmadhimi i Kapitalit, Kalimi i Kuotave të Kapitalit

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "DronesVision Albania" SHPK është 1,000,000 (një milion) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortakut i

vetem Roger Hugli, i cili zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 1,000,000 (një milion) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 100 % (njëqind përqind) në kapitalin e shoqërisë.

NENI 9

Zmadhimi i Kapitalit të Regjistruar

9.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet pa kull, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

NENI 10

Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar

10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kështuuar nga ligji.

10.2 Zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital, me përjashtim të rasteve kur në bazë të ligjit ose të statutit Asambleja e Përgjithshme mund të vendosi ndryshe.

NENI 11

Kalimi i Kuotave të Kapitalit të Regjistruar

11.1 Kuota e kapitalit mund t'u kalohen tërësisht ose pjesërisht të tretëve nga ortakët i vetëm i shoqërisë.

11.2 Në rast se shoqëria do të ketë më shumë se 1 ortak, kuota/t e kapitalit mund t'u kalohen tërësisht ose pjesërisht të tretëve, ortakë ose jo ortakë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri me kushtëzim të mëposhtim:

- Ortakët e shoqërisë kanë të drejtën e parablertjes për kuotën që dëshiron të shesë njëri prej ortakëve të shoqërisë.
- Ortakët që dëshiron të shesë kuotën e tij ia ofron atë ortakëve të tjerë nëpërmjet administratorit.
- Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablertjes së kuotës me të njëjtat kushte dhe me të njëjtën çmim që ortakët mund t'ia shesë këtë kuotë njëri të treti që nuk bën pjesë në shoqëri.
- Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së ofertës, ortakët e tjerë duhet të përgjigjen për ushtrimin e të drejtës së parablertjes ose, në të kundërt, do të konsiderohet se ata kanë hequr dorë prej saj.
- Në rast se ortakët që do të ushtrjnë të drejtën e parablertjes janë më shumë se një, kuota ndahet ndërmjet tyre në pjesë të barabarta.
- Në rast se ortakët nuk e ushtrjnë të drejtën e parablertjes për kuotën që dëshiron të shesë njëri prej ortakëve të shoqërisë atëherë kjo e drejtë mund të ushtrohet nga vetë shoqëria.

Ortakët që dëshiron të shesë kuotën e tij ia ofron atë shoqërisë.

Shoqëria ka të drejtën e parablertjes së kuotës me të njëjtat kushte dhe me të njëjtën çmim që ortakët mund t'ia shesë këtë kuotë njëri të treti që nuk bën pjesë në shoqëri.

Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së ofertës, shoqëria duhet të ushtrojë të



drejtën e parablertjes ose, në të kundërt, do të konsiderohet se ajo ka hequr dorë prej saj). Në rast se shoqëria vendos ta ushtrojë të drejtën e parablertjes ajo duhet të autorizojë administratoren për të blerë kuotën dhe të vendosë anulimin e saj. Në këtë rast, shoqëria duhet të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vlerën nominale të kuotës së anuluar. Si pasojë e këtij zvogëlimi të kapitalit do të ndryshojë edhe raporti i pjesëmarrjes në kapital të ortakëve të shoqërisë.

- Në rast se ortakë që tjetërsin kuotën e vet, ia shet atë një të tretë jashtë shoqërisë, me gjum dhe kushte më të favorshme nga ato që ua ka ofruar ortakëve dhe shoqërisë për efekt të ushtrimit të së drejtës së parablertjes nga ana e tyre, atëherë kontrata e shijes që ortakë do të lidhë me personin e tretë do të jetë e pavlefshme dhe shoqëria nuk do të japë miratimin për këtë kalam.

11.3 Në rast se ortakë/et tjetërsin kuotën/at nëpërmjet një kontrate dhurimi, kalam të drejtash të Përgjithshme për këtë kalam. Vendimi për marrjen e këtij miratimi do të jetë sipas shumicës së etj, oraku/et i cili/te tjetërsin kuotën do të duhet të marrë miratimin e Asamblesë së Përgjithshme në nenin 16.1 të këtij statuti.

11.4 Kuota janë lirisht të transferueshme nëpërmjet trashëgimisë.

11.5 Të gjitha njoftimet në funksion të zbatimit të këtij neni do të bëhen nëpërmjet postes elektronike (email).

KREU IV

Organet e Shoqërisë

NENI 12

Asambleja e Përgjithshme

Organi vendimmartës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

NENI 13

Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërtimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërtimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshi përgatitjen e autorizuar;
- përcaktimin e shpërblyeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- miratimin dhe pasqyrtat financiare vjetore dhe të raporteve të ecutisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përtaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- anulimin e kuotave;

- largimin ose përjashtimin e ortakut;
- gëshije të tjera të parashikuara nga ligji apo nga ky statut.

NENI 14

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

14.1 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rasti e përcaktuara nga ligji dhe nga ky statut, sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

14.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret të pakten një herë në vit.

14.3 Asambleja e Përgjithshme thirret në respektim të parashikimeve të nenëve 83 dhe 84 të ligjit Nr. 9901, datë 14.01.2008 "Për rregullat dhe shoqëritë tregtare". Njoftimi për mbledhje duhet të dërgohet jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

14.4 Ortakët do të njoftohen për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me anë të postës elektronike. Adresat elektronike ku do të regjistrohet në regjistrin e ortakëve. Dërgimi i njoftimit në këto adresë do të konsiderohet si njoftim i kryer rregullisht. Ndryshimi i këtyre adresave do të duhet të njoftohet administratorit.

14.5 Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës.

14.6 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet në zyrën qendrore (selinë) të shogërisë ose dhe online nëpërmjet videokonferencës për faktin se ortakët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Konfirmimi për zhvillimin e mbledhjes online dërgohet në adresën elektronike të administratorit. Për zhvillimin e mbledhjes online, duhet të jenë pro ortakët të cilët përfaqësojnë 51% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 15

Pjesëmarrja në Vendime

15.1 Çdo ortak ka të drejtë vote në përpyesim me kontributin e tij në kapitalin e shoqërisë.

15.2 Çdo ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga një ortak ose nga një person i tretë, në bazë të një autorizimi. Ky autorizim mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend ditë.

15.3 Ortaku nuk mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga Administratori.

NENI 16

Kuorumi

16.1 Mbledhjet e asamblesë së përgjithshme, për gëshije të zakonshme, janë të vlefshme nëse të marrin pjesë personalisht ose të përfaqësojnë, ortakët të cilët zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë. Në këtë rast, për vendime të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme merr vendime me 51% të votave pro të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.

16.2 Për vendime të cilat kërkojnë një shumicë të cilësuar, si ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, anulimi i kuotës së kapitalit, largimi i ortakut, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme me $\frac{3}{4}$ e votave pro të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje. Mbledhja në këtë rast konsiderohet e vlefshme nëse marrin pjesë personalisht ose të përfaqësojnë, ortakët që zotërojnë më shumë se 75% të kapitalit të shoqërisë.

16.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në nenin 17.1, asambleja mbledhet përsej 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 17

Procesverbali i Mbledhjes dhe Vendimet

17.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali përban datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të Mbledhjes, emrin e Mbatjesit të Procesverbali, rezultatet e votimit.

17.2 Për mbajtjen e procesverbali, Kryetari i Mbledhjes cakton një Mbatjes Procesverbal, i cili mund të mos jetë ortak. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari i Mbledhjes dhe Mbatjesi i Procesverbali.

17.3 Procesverbali i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

17.4 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme nënshkruhen nga ortakët e shogërisë. Në rastin kur mbledhja zhvillohet online vendimi i Asamblesë hartohet dhe i dërgohet ortakëve nga Kryetari i Mbledhjes nëpërmjet email. Ortakët e nënshkruajnë atë me firmë elektronike dhe ia nisin aktin e nënshkruar nëpërmjet postës elektronike administratort dhe ortakëve të tjerë.

Administratori

NENI 18

18.1 Administratori është organi ekzekutiv i shogërisë.

18.2 Shogëria administrohet nga një ose dy administratorë që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Atëu i emërtimit është 5 vjet me të drejtë riptëritje.

18.3 Administratori ka të drejtë të kryejë administrimin e zakonshtëm dhe të jashtëzakonshtëm të shogërisë. Ai ka të drejtë të përfaqësojë shogërinë pranë çdo organi shtetëror si dhe në marrëdhënie me të tretët; të hartojë dhe të nënshkruajë çdo dokument të nevojshëm lidhur me mbartëvajtjen e aktivitetit të shogërisë si dhe të depozitojë ato pranë çdo organi kompetent shtetëror, apo personave të tretë privatë, në përpunje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Të kujdeset për mbartëvajtjen e punëve të përditshme të shogërisë, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me mbikëqyrjen e personellit; punësimin dhe pushimet nga puna të personellit; dhënie e udhëzimeve lidhur me mënyrën e menaxhimit të punëve në shogëri; mbajtjen e korrespondencës së shogërisë; dhënie e autorizimit për blerjen, marrjen me qira etj. të mallrave apo shërbimeve të zakonshtëm të cilat lidhen në mënyrë direkte apo të tërthorë me punën e përditshme të shogërisë; autorizimin për kryerjen e transferimeve bankare apo tërheqjen e shumave të nevojshme nga llogaritë e shogërisë lidhur me pagat apo shpërbllimet e punonjësve të shogërisë; Të përpilojë dhe të nënshkruajë faturat tatimore që do të lëshohen në emër të shogërisë si rezultat i punëve të kryera; Të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme dhe të nënshkruajë çdo dokument për kryerjen e pagësive bankare, depozitime, tërheqje, derdhje, si dhe transferime apo levizje të çdo lloji në llogaritë bankare të Shogërisë, në të gjitha numrat e llogaritë (Euro, Lekë dhe USD) të Shogërisë, pranë çdo bankë ku ndodhen këto llogaritë.

18.4 Asambleja e Përgjithshme mund të kufizojë veprimet e administratorit të shogërisë.

18.5 Administratori i parë i shogërisë do të jetë ortak i vetëm Roger Hugli.

Eksperti Kontabël, Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor, Shpërndarja e Fitimeve

KREU V

NENI 19

Eksperti kontabël

Nëse është e nevojshme ose kërkohet nga ligji, kontrolli i bilanci financiar dhe i librave të kontabilitetit të Shogërisë do t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar, të emëruar nga

Shogëria.

NENI 20

Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor

Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.
Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecursë së veprimtarisë dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
Dokumentet që kanë të bëjnë me ushtrimin e viti financiar do të miratohen brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i viti financiar.

NENI 21

Shpërndarja e Fitimeve

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shogërisë.
Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
Shogëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:
• aktivet e shogërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
• shogëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

KREU VI

Riorganizimi i Shogërisë, Prishja dhe Likuidimi i Shogërisë, Largimi dhe Përjashtimi i

Ortakëve

NENI 22

Prishja dhe Likuidimi i Shogërisë

22.1 Shogëria priset në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
Në rast prishje shogëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.
22.2 Për procedurën e likuidimit të Shogërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

KREU VII

Dispozita të Fundi

NENI 23

Të gjitha mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim kompetentë për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Shkalës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Rogent Huxi



ROBERT HUQI

ORTAKU THEMELUES

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe.

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi.